



MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 768 Prot.

Tiranë, më 19.07 2016

VENDIM Nr. 79, datë 15.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9 të datës 15.07.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi konceptin e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën ku pozicionohet shtylla Nr. 22 (sondazhi 8)*, në kuadër të projektit "*Linja 110 KV, Llapaj - Peshkopi*"-OST SH.A., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin mbi konceptin e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën ku pozicionohet shtylla Nr. 22 (sondazhi 8)*, në kuadër të projektit "*Linja 110 KV, Llapaj -Peshkopi*"-OST SH.A., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj.
2. Investitori-OSTsh.a. për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji, duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me këtë subjekt dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al